

REQUEST FOR INFORMATION (RFI)

Për shërbimet “LOT 1 – Mbikëqyrja Arkitekturore, e Fasadës së Kombinuar, Hidroizolimit, Rifiniturave Premium dhe Peizazhit” dhe “LOT 2 – Mbikëqyrja MEP, ELV dhe Sisteme Speciale”

Union Bank SHA, në kuadër të përgatitjes së procesit të prokurimit për projektin Union Bank HQ Albania, fton ofruesit e shërbimit të interesuar të paraqesin informacion paraprak mbi kapacitetet, eksperiencën, metodologjinë, ekipin e punës dhe kushtet orientuese për ofrimin e shërbimeve të mbikëqyrjes për dy objekte të veçanta cilesuar ne: LOT 1 dhe LOT 2.

Ofruesit e shërbimit mund të paraqesin përgjigje për të dy scope-et, LOT 1 dhe LOT 2, ose vetëm për njërin prej tyre, sipas kapaciteteve, licencave, eksperiencës dhe fushës së tyre të specializimit. Në rast se një ofrues shërbimi paraqet informacion për të dy LOT-et, përgjigja duhet të jetë e ndarë qartë për secilin LOT, ekipi perkates, metodologji, eksperiencë dhe kushte orientuese të identifikueshme veçmas.

Kërkesa për Informacion nuk përbën ftesë për ofertë, procedurë tenderimi apo angazhim kontraktual nga ana e Bankës. Qëllimi i tij është mbledhja e informacionit nga tregu për të vlerësuar disponueshmërinë e ofruesve të shërbimit të kualifikuar, praktikat më të mira, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe parametrat kryesorë teknikë e komercialë që mund të merren në konsideratë në një fazë të ardhshme prokurimi.

1. Qëllimi i Kërkeses për Informacion

- Të identifikojë ofrues shërbimi me eksperiencë të dokumentuar në një ose të dy scope-et e mbikëqyrjes: LOT 1 dhe/ose LOT 2;
- Të kuptojë kapacitetet teknike, profesionale dhe organizative të tregut për realizimin e mbikëqyrjes periodike, jo rezidente, për një objekt kompleks bankar/HQ;
- Të marrë informacion mbi metodologjitë e kontrollit, raportimit, dokumentimit, menaxhimit të moskonformiteteve dhe koordinimit ndërdisiplinor;
- Të vlerësojë modele të mundshme angazhimi, frekuencë vizitash, strukturë ekipi, pika kontrolli dhe kushte orientuese komerciale për secilin LOT;
- Të përmirësojë dhe finalizojë kërkesat teknike dhe kushtet e mundshme të një procesi pasues RFP/RFQ, duke ruajtur ndarjen e qartë ndërmjet LOT 1 dhe LOT 2.

2. Informacion i përgjithshëm mbi projektin

Objekti i projektit është Godinë Administrative me 4–6–17–18–19 kate dhe 4 kate nëntokë, me vendndodhje në Bulevardin “Bajram Curri”, Tiranë. RFI mbulon dy scope të ndara mbikëqyrjeje: LOT 1 për punimet arkitekturore, fasadën e kombinuar, hidroizolimin, rifiniturat premium dhe peizazhin; dhe LOT 2 për sistemet mekanike, elektrike, hidraulike, mbrojtjen nga zjarri, ELV/ICT, BMS dhe sisteme speciale. Të dy scope-et do të trajtohen si të ndara në përgjigje, edhe kur ofruesi i shërbimit shpreh interes për të dyja.

3. Struktura e përgjigjes dhe mënyra e pjesëmarrjes

- Ofertuesi i Sherbimit duhet të deklarojë qartë në fillim të përgjigjes nëse shpreh interes për LOT 1, për LOT 2, apo për të dy LOT-et;
- Nëse operatori përgjigjet për të dy LOT-et, informacioni duhet të paraqitet i ndarë në dy pjesë të veçanta: një pjesë për LOT 1 dhe një pjesë për LOT 2;
- Për secilin LOT duhet të paraqiten veçmas eksperiencia relevante, licencat, ekipi i propozuar, metodologjia, frekuenca e propozuar e vizitave, pikat kritike të kontrollit dhe kushtet orientuese komerciale;
- Nëse i njëjti ekspert ose e njëjta kompani propozohet për të dy LOT-et, duhet të sqarohet kapaciteti real i angazhimit dhe mënyra se si do të shmangen konfliktet e burimeve, mbivendosjet ose mungesa e disponueshmërisë;
- Banka rezervon të drejtën të përdorë informacionin e marrë për të strukturuar një ose më shumë procese pasuese prokurimi, për secilin LOT veçmas ose sipas modelit që konsiderohet më i përshtatshëm.

4. Scope i LOT 1 – Mbikëqyrja Arkitekturore, Fasada, Hidroizolimi, Rifiniturat Premium dhe Peizazhi

- Mbikëqyrja arkitekturore e punimeve të zbatimit, përfshirë ndarjet, tavanet, hapjet, dyert, detajet përfundimtare dhe punimet e maskuara arkitekturore;
- Mbikëqyrja e fasadës së kombinuar, duke përfshirë sisteme xhami, panele, veshje, nënstruktura, ankorime, fuga, nyje dhe ndërfaqe me strukturën, çatinë, hidroizolimën dhe sistemet teknike;
- Mbikëqyrja e hidroizolimit për katet nëntokë, çati, nyje, penetrim, drenazhime, shtresa mbrojtëse dhe testime të nevojshme;
- Mbikëqyrja e rifiniturave premium, zonave publike dhe ekzekutive, dhomave/zonave model, listave të mangësive dhe cilësisë estetike të zbatimit;
- Mbikëqyrja e punimeve të peizazhit dhe ndërfaqeve me punimet arkitekturore, drenazhimin, ndriçimin e jashtëm dhe elementet teknike të ekspozuara.

5. Scope i LOT 2 – Mbikëqyrja MEP, ELV dhe Sisteme Speciale

- Mbikëqyrja mekanike: HVAC, ventilim, smoke extraction, dhoma teknike, pajisje mekanike, tubacione dhe izolime teknike;
- Mbikëqyrja hidraulike/sanitare: furnizim me ujë, kanalizime, drenazhime, pompa, depozita, pajisje sanitare dhe ndërfaqe me strukturën/arkitekturën;
- Mbikëqyrja e mbrojtjes nga zjarri: hidrante, sprinkler, pompa zjarri, tubacione, valvula, testime presioni dhe prova funksionale;
- Mbikëqyrja elektrike: furnizim kryesor, tension i mesëm/ulët sipas projektit, panele, transformatorë, gjenerator, UPS, ndriçim, tokëzim, rufepritës dhe instalime të brendshme;
- Mbikëqyrja ELV/ICT dhe sisteme speciale: alarm zjarri, CCTV, kontroll aksesit, kabllim i strukturuar, rrjete të dhënash, BMS, sisteme sigurie, audio/video dhe integritet teknike;
- Mbikëqyrja e ndërfaqeve teknike me LOT 1 dhe me karabinanë, përfshirë tavane, shaft-e, penetrim, mbyllje arkitekturore, firestopping, fasadë, çati dhe dhoma teknike.

6. Informacioni që kërkohet nga ofruesit e shërbimit

Për secilin LOT për të cilin ofruesi i shërbimit shpreh interes, duhet të paraqiten informacionet si më poshtë:

- profilin e kompanisë,
- licencat dhe certifikimet relevante,
- eksperiencën në projekte të ngjashme,
- ekipin e propozuar,
- metodologjinë e mbikëqyrjes,
- mënyrën e raportimit,
- pikat e detyrueshme të kontrollit,
- menaxhimin e moskonformiteteve,
- koordinimin me palët e tjera dhe kushtet orientuese komerciale.

7. Pyetje orientuese për ofruesit e shërbimit

Ofruesit e shërbimit duhet të japin përgjigje të ndara për secilin LOT për të cilin shprehin interes, duke adresuar: eksperiencën kryesore dhe referencat; strukturën e ekipit; pikat kritike të kontrollit; frekuencën e rekomanduar të vizitave; formatet e raportimit; menaxhimin e moskonformiteteve dhe çështjeve urgjente; dokumentacionin e nevojshëm para fillimit; risqet kryesore teknike; modelin e tarifimit; dhe çdo KPI, penaltet ose mekanizëm performance-based që konsiderohet i përshtatshëm.

8. Dokumentacioni që kërkohet të dorëzohet në përgjigje të RFI-së

- Prezantim i shkurtër i kompanisë dhe të dhënat e kontaktit;
- Deklarim i qartë nëse përgjigja paraqitet për LOT 1, LOT 2 apo për të dy LOT-et;
- Lista e projekteve të ngjashme të realizuara ose në proces, e ndarë sipas LOT-it përkatës;
- Licencat, certifikimet dhe informacion mbi sigurimin e përgjegjësisë profesionale, sipas fushës përkatëse;
- Përmbledhje e ekipit të mundshëm, kualifikimeve, roleve dhe disponueshmërisë së ekspertëve kryesorë;
- Përshkrim i metodologjisë së rekomanduar të mbikëqyrjes, raportimit, hold points dhe menaxhimit të moskonformiteteve;
- Shembuj ose përshkrim i formateve të raportimit, regjistrave teknikë, NCR, snagging dhe raporteve periodike;
- Informacion orientues mbi strukturën e kostos dhe kushtet e pagesës, i paraqitur veçmas për secilin LOT, pa qenë ofertë financiare detyruese.

9. Dorëzimi i përgjigjes ndaj RFI-së

Përgjigjet ndaj këtij RFI duhet të dorëzohen në format elektronik në adresën **procurement@unionbank.al**, me subjekt “RFI – LOT 1 dhe/ose LOT 2 – Mbikëqyrja për Union Bank HQ Albania”. Në tekstin e email-it dhe në dokumentacionin shoqërues duhet të specifikohet

qartë nëse përgjigja i referohet LOT 1, LOT 2 apo të dy LOT-eve. Afati i dorëzimit do të përcaktohet nga Banka në komunikimin përkatës me ofruesit e shërbimit të interesuar.

10. Konfidencialiteti dhe përdorimi i informacionit

Informacioni i dorëzuar nga ofruesit e shërbimit do të përdoret vetëm për qëllime të analizës së tregut dhe përgatitjes së dokumentacionit të mundshëm të prokurimit për LOT 1 dhe/ose LOT 2. Dorëzimi i informacionit në përgjigje të këtij RFI nuk garanton pjesëmarrje, kualifikim apo përzgjedhje në ndonjë procedurë të ardhshme, si dhe nuk krijon detyrim për Bankën për të vijuar me një proces tenderimi ose kontraktim.